

VENDIM
Nr. 130, datë 29.8.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“AYEN AS ENERGJI” SHA, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR NJË AFAT 5-VJEÇAR (PESËVJEÇAR).**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., si dhe relacionin me nr. 79/8, datë 26.8.2019 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AYEN AS ENREGJI” sh.a., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

- Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a, ka aplikuar në ERE për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 514/2 prot, datë 22 .8.2019.

- Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a, zotëron licencën për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me nr. 241, seria T14, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 79, datë 9.9.2014, për një periudhë 5-vjeçare, periudhë e cila përfundon në datën 9.9.2019.

- Aplikimi i shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me azhurnimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germa “a” (prokura e përfaqësimit të të deleguarit), si kërkesë e nenit 7, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “a” (vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore), paraqitur jo në përputhje me kërkesat e nenit 8, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Do të njoftohet subjekti që në bazë të Rregullores sipërcituar, neni 10, pika 9 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë e procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti